



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. _____ Prot.

Fier, më _____ 02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Blerje bojra per printera dhe fotokopje”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

“Toner per printer lazer/makina fax”- 30125110-5

“Toner për makinat fotokopjues”- 30125120-8

VLERA E FONDIT LIMIT: prej **8 333 333** (*tete milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre*) **lekë pa TVSH dhe 9 999 999.6** (*nente milion e nenteqind e nentedhjetë e nente mijë e nenteqind e nentedhjetë e nente pike gjashtë*) **leke me TVSH** ,
vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkise Fier

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

.....
I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos-+ bazuar ne nenin 82 të ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”*Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik*” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të*

treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se **3 000 000 leke pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.; në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar;

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperm eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”* i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur e thjeshtuar, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar*; Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit nen kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat”* i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohe dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Ne kete rast vlera e kerkuar eshte jo me pak se **1 200 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese një nga dokumentat e meposhtem:

- a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **1 200 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet)** që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, piken 4 të nenit 40 dhe piken 4/b të nenit 55 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 *“Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë nga prodhuesi ose format katalogu ose broshurë të realizuar edhe nga OE (operatori ekonomik) për të gjithë artikujt e tjerë (përveç atyre të kërkuar si mostra), i cili duhet të përmbajë minimalisht këto të dhëna: artikulli nr., emërtimi, prodhuesi, ngjyra, kodi i produktit, numri i faqeve, foto ose linku ku mund të gjenden të dhënat e artikullit. Në rastin kur katalog/broshurë ose fragment katalogu ose broshurë është në gjuhën shqipe, nuk ka nevojë të përkthehet dhe noterizohet por në rastin kur është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Argumentimi: Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

Paraqitja e katalogjeve per zerat e mallrave, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise se mallrave qe operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike te percaktuara ne DST.

2.3.3 Operatorët Ekonomikë pjesemarrës duhet të paraqesin mostrat (*kampionet*) **për disa prej artikujve te kerkuar si me poshte**, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Mostrat do te dorezohen perpara komisionit, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, ne Sallen e Mbledhjeve te Bashkise Fier, Kati II, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Lista e artikujve per te cilet kerkohen mostra eshte si me poshte:

Nr	Emërtimi i pajisjes, bojrave (tonerave)	Part Number (Ose ekuivalenti)	Kapaciteti/mi nimumi i fleteve	Njësia	Sasia e mostrave
3	Xerox Versa Link B7025/B7030/B7035 MFP	106R03396	30000	cope	1
4	XXR DRUM VERSALINK B7000,	113R00779	80000	cope	1
11	Lexmark Laserjet MB2236 adw multifunksional	B222X00	6000	cope	1
12	Imaging Unit Lexmark Laserjet MB2236adw multifunksional	B222Z00	12000	cope	1
17	Lexmark B2650 Toner	B262U00	15000	cope	1
19	Xerox B225	006R04404	6000	cope	1
22	Xerox B400	106R03583	13900	cope	1
41	Boje Brother DCP-L2600D	TN-2590XL	3000	cope	1

42	Drum Brother DCP-L2600D	DR-2590	15000	cope	1
----	-------------------------	---------	-------	------	---

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s'kualifikimi për vazhdimin e procedures.

Argumentimi: Referuar VKM nr 285 dt 19.05.2021 “Per Miratimin e rregullave te prokurimit public” neni 40 pika 6 është përcaktuar se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

AK (Grupi i punes) e ka pare te nevojshme kerkesen per te dorezuar mostra vetem per artikujt (bojera printeri) me sasite me te medha te parashikuara ne kete rpocedure prokurimi. Artikujt me sasi me te medha perbejne peshen kryesore financiare te kontrates dhe mbulojne volumin me te madh te perdorimit ne institucion. Si te tille ata kane ndikim me te madh ne cilesine e sherbimeve dhe funksionimin e perditshem te pajisjeve. Materialet e konsumit per pajisje printimi ndikojne drejtperdrejt ne funksionimin dhe jetegjatesine e tyre. Perdorimi i produkteve qe nuk permbushin standartet teknike mund te shkaktoje demtim te pajisjeve. Kekerkesa per mostra zbatohet ne menyre te njejte per te gjithë operatorët ekonomike pjesemarresduke garantuar: trajtim te barabarte; vleresim objektiv; transparence ne procesin e shqyrtimit te ofertave. Artikujt per te cilet kerkohen mostra jane materiale konsumi qe ndikojne drejtperdrejt: ne performancen dhe jetegjatesine e pajisjeve; ne cilesine e printimit; ne kostot e mirembajtjes se institucionit. Jo te gjithë artikujt paraqesin te njejtin nivel risku teknik. Per kete arsye kontrolli fizik eshte konsideruar i nevojshem vetem per artikujt me ndikim me te larte teknik dhe operacional.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe argumentuar nga grupi i punes i ngritur nga zv.Kryetari i Bashkisë me Urdhërin nr.560 datë 16.01.2026 dhe derguar me shkresen nr.2499/1 prot date

24.02.2026, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar. Kriteret teknike te vecanta te kualifikimit lidhur me kapacitetin teknik jane hartuar e argumentuar nga grupi i punes.

Bashkelidhur DST në SPE.

Specifikimet teknike nuk kane asnje kerkese apo reference te ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, pervec kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme e saktë ose e kuptueshme e pershkrimit te kerkesave me kusht qe fjala “ose ekuivalent” perfshihet detyrimisht ne keto specifikime.

Shenim: Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe preventive mund te jete perdorur si reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik, perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

Njësia e Prokurimit:
